



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGISË
BORDI**

VENDIM

Nr.119, Datë 17.07.2020

“MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A. PËR ZGJATJEN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN
E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”;; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 86/1 prot, datë 08.07.2020 e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikeqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. “Për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e Shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/55 Prot., datë 25.11.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 729/1 Prot, datë 03.12.2019, ka përcjellë pranë subjektit “Albgaz” sh.a., njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës si dhe mungesën e dokumentacionit të konstatuar.
- Me shkresat nr. 84 prot, datë 16.01.2019 dhe nr. 288/1 Prot, datë 04.02.2020, ERE i është drejtuar Shoqërisë me një kujtesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 288/2 Prot, datë 08.02.2020, ka përcjellë në ERE kërkesën për shtyrje të vendimmarrjes së bordit, në pamundësi për ti plotësuar këto dokumenta brënda afateve dhe ka deklaruar se një pjesë e tyre është në proces përpilimi.
- Bordit i ERE me vendimin nr. 43, datë 06.03.2020, vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë për shtyrjen e vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë, deri në datën 01.07.2020.

- Së fundmi, (përpara përfundimit të këtij afati), shoqëria Albgaz sh.a. me shkresën nr. 122/1 prot., datë 29.06.2020, protokolluar në ERE me nr. 288/4, datë 29.06.2020, ka paraqitur sërish në ERE kërkesë për shtyrjen e vendimmarjes së Bordit mbi këtë licencim, deri në datën 10.10.2020, duke argumentuar se për shkak të mbylljes së çdo shërbimi që erdhi si rezultat i pandemisë COVID -19, nuk ka patur mundësi të plotësojë dokumentacionin e munguar dhe kërkon miratimin e ERE-s për të shtyrë këtë vendimmarje.
- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të vendimit të bordit, është depozituar përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 43, datë 06.03.2020 dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, kërkesa e shoqërisë është e arsyeshme dhe e bazuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e Shoqërisë “Albgaz” sh.a. për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 10.10.2020.
2. Shoqëria Albgaz sh.a., të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar, jo më vonë se data 01.10.2020
3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarreveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI